

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E HËNË 31 TETOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Kolegë të nderuar,

“Me sa duken bathët, është larg pranvera”, thonë. Ju e keni vendosur që nuk keni asnjë synim për të ndërmarrë diçka lidhur me reformën territoriale. Besoj se kjo do të ngelet në analet e këtij parlamenti si një nga njollat tuaja më të zeza, për disa arsye fare të thjeshta. E para, sot që diskutojmë, është vetëm një raport, ai i Partisë Demokratike. Ju nuk keni asnjë raport, por keni ardhur me një fletë letre të bardhë, ku thoni: “Të ngelet siç ishte”. Kaq! Ju nuk gjeni dot asnjë arsye. Pse e pranuat, në fakt, këtë komision 6 muaj më parë?! Cila ishte arsyeja, nëse që në atë kohë e kishit marrë parasysh se nuk do të ndryshonit asgjë?

Zoti Ministër, ajo që thatë pak më parë, që vlera e këtij komisioni ishte që nëpërmjet këtij komisioni të shikoni se ku ka arritur pushteti lokal, është një autogol i madh. Në fakt, ti, je ministri i ngarkuar nga qeveria që ta shohësh përditë. Sapo pranove o paaftësinë tënde, o faktin që nuk të intereson asgjë lidhur me pushtetin lokal. Bashki të falimentuara, bashki pa shërbim, bashki në distancë me shumë kilometra nga njëri skaj, në skajin tjetër, bashki pa transport publik, bashki që vendosin taksë gjelbërimi në mes të pyllit, është reforma që ke bërë ti. Bashki pa histori, bashki që nuk kanë identitet, vetëm me “Rilindjen urbane” që ju bëtë para disa vitesh, pra i keni shndërruar të gjitha në fotokopje të njëra-tjetrës dhe nuk dallon cila është njëra apo tjetra.

Bashki pa tradita, bashki që po shpopullohen, dhe kjo është një nga arsyet më të rëndësishme përse është e nevojshme sot që të rishihej edhe njëherë reforma territoriale, në mënyrë që grumbullimet e reja të ishin të tilla që t’i mbanin shqiptarët aty, të cilët jo vetëm po ikin jashtë shtetit, por edhe nga periferia po vijnë në qendër. Kjo është një nga arsyet më të forta përse duhej bërë. Bashki pa demokraci lokale! Këtë nuk kuptoni ju, por pushteti vendor, nëse ka një vlerë, është pikërisht kjo: është e drejta, mundësia, kapaciteti, komoditeti që u jepet qytetarëve që të kontrollojnë përditë kryetarin e bashkisë. Kjo ka qenë një nga arsyet më të mira për të vendosur, po të doni ju, edhe pa qenë politike, sepse e kuptoj fare mirë që pushtetin qendror të atij që është dhe nuk është, që fluturon, e kanë larg, e shohin lart, ndërkohë, nëse ka një arsye të fortë përse bëhen disa reforma të mëdha, që nuk duhen parë

ndaras, majtas apo djathtas politikisht, njëra prej të cilave është kjo, është pikërisht reforma e pushtetit vendor.

Niveli i demokracisë në një vend shihet nga pushteti vendor. Janë gjetura ato të tjerat, drejtësia, pavarësia e me radhë. Jo, niveli i demokracisë, niveli i respektimit të individit, është pikërisht te pushteti vendor: sa peshë, sa fuqi, sa zë ka individi tek ai administratori i përditshëm që sheh nga mëngjesi deri në darkë, që thotë: “Mirëmëngjesi e mirëmbrëma!”. Ky do të duhej të ishte virtyti i një reforme territoriale. Ky momenti i sotëm që ndërmorëm ne, që, me sa duket, ju e paskeni pasur me të tallur, në fakt, i kishte disa vlera, dhe njëra nga vlerat kryesore ishte fakti që në vitin 2014, kur ju e ndërmorët (e thatë edhe këtë zonja Denaj, ndoshta në mënyrë jo të ndërgjegjshme, që kjo ishte një nga arritjet e qeverisë “Rama”), pikërisht, pra, reforma territoriale nuk duhej të ishte e njëanshme dhe duhet të gëzonte legjitimitet nga maxhoranca dhe nga opozita.

Unë kam guximin ta them këtu që ndoshta një pjesë të fajit në vitin 2014 e kemi edhe ne, të Partisë Demokratike, kur nuk morëm pjesë. Megjithatë, ju votat i kishit, të jemi të vërtetë me historinë, siç edhe e bëtë, por nuk morët një gjë të rëndësishme për reformën territoriale, që është pikërisht legjitimiteti, gjithëpranueshmëria. Reforma territoriale është një nga momentet historike në shtetformim. E, pra, kjo është ajo çfarë ua mohuat shqiptarëve atëherë dhe sot nuk po ua jepni. Jo vetëm kaq, me të drejtë e tha kolegja Çupi, ne nuk nisemi nga ideja e rrafshimit të gjithçkaje, edhe ju, zoti Ministër; nuk po themi që gjithçka nuk ka funksionuar, jo, ne kemi kërkuar korrigjim të defekteve të identifikuar në këta 7 vjet, sepse vetëm kështu ecën para kjo dynja, me evolucion, jo me revolucion dhe besoj se është filozofia më e mirë, e cila, në fakt, ka dhënë edhe produktet e saj.

E fundit, të mos ua fshehim njerëzve, e kuptoj fare mirë sot përse ju nuk gjeni dot as alibi, as justifikim, ka vetëm një arsye përse ju nuk pranoni një ridimensionim në të mirë të shqiptarëve të reformës territoriale. Në vitin 2014, kur e bëtë vetëm, e bëtë për një arsye fare të thjeshtë: t’i fitonit zgjedhjet në tavolinë. Kjo është kaq e qartë! Ia morët frytin në vitin 2015, e vazhduat më tej, ndoshta edhe për fajin tonë, e pranoj, por pas 7 vjetëve, kur keni korrur maksimumin në mënyrë të padrejtë të fryteve elektorale, politike, financiare, korruptive të kësaj reforme, duhet të bënit edhe një gjë të vogël për shqiptarët, t’u jepnit atyre pushtetin vendor, sepse i tyri është. Me këtë qëndrim të sotëm nuk po bëni gjë tjetër veçse po i vidhni në tavolinë edhe zgjedhjet e vitit 2023. Faleminderit!